



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 398/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani Kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga kandidatja për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës Arbëresha Ajdini - Nallbani nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Pejë, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paraqitur nga Arbëresha Ajdini - Nallbani kandidate për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga AAK-së, dega në Pejë.

Arsyetim

PZAP-i, me datën 27.06.2014 në ora 09.33 ka pranuar një ankesë nga Arbëresha Ajdini - Nallbani kandidat për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e AAK-së, me numër 42 në të cilën ankesë pretendon se sipas informatave që ka nga komisionerët e disa vendvotimet në Komunën e Pejës, kanë shkuar në rinumërim si në Shkollën fillore “Vaso Pashë Shkodrani” VV nr: 1702C, Shkolla fillore “Lidhja e Prizrenit” VV nr: 1703C, Shkolla fillore “Ramiz Sadiku” VV nr: 1704C, Fakulteti i Biznesit “Haxhi Zeka” VV nr: 1704X, dhe Shkolla fillore “Xhemajli Kada” VV nr: 1705C, ku pretenduesja e ankesës pohon se ju kanë anashkaluar dhe nuk ju kanë regjistruar votat në këto vendvotime. Andaj parashtron këtë ankesë në lidhje me administrimin e numërimit në QNR sipas nenit 105.1 të LZP-së, dhe kërkon që të bëhet rinumërimi i votave të saj në vendvotimet e lartpërmendura. Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe shkresat e lendes gjeti se

- **ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore të Arbëresha Ajdini - Nallbani kandidat për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e AAK-së, janë të pabazuara pasi që

ankesës në fjalë nuk i ka bashkangjitur asnjë provë me të cilën mund të vërtetohen shkeljet e supozuara. Nëse në vendvotimet në fjalë janë rinumëruar fletëvotimet, ankuesi nuk ka dhënë dëshmi se votat eventuale ekzistuese në ato kuti nuk i janë regjistruar dhe llogaritur në rezultatin final zgjedhor. Për më tepër rinumërimi behet me qëllim të korrektimit të numërimit të fletëvotimeve.

Andaj një pretendim i tillë është i pa bazuar dhe në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe në bazë të nenit 3.6 pika b) të Rregullave dhe Proceduarave të PZAP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.398/2014 më datën 27.06.2014.



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*